

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
INXHINIERI SOFTUERIKE DHE WEB DIZAJN



Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime

PUNIM DIPLOME

Mentore:

Prof.Ass.Dr. Lindita Loku Nikçi

Kandidati:

Shëndrit Koprani

Gjilan, Mars 2025

UNIVERSITETI PUBLIK “KADRI ZEKA”
FAKULTETI I SHKENCAVE KOMPJUTERIKE
INXHINIERI SOFTUERIKE DHE UEB DIZAJN



Platforma digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime

PUNIM DIPLOME

Lënda:	Zhvillimi i Web Aplikacioneve
Titulli i punimit:	Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime
Emri dhe mbiemri:	Shëndrit Koprani
Statusi i studentit:	I rregullt
Numri i amzës:	19071047
Niveli i studimeve:	Bachelor
Drejtimi:	Fakulteti i Shkencave Kompjuterike
Programi i studimit:	Inxhinieri Softuerike dhe Web Dizajn
Mentori i punimit:	Prof.Ass.Dr. Lindita Loku Nikçi

Gjilan, Mars 2025

Abstrakti

Ky punim diplome trajton zhvillimin dhe implementimin e platformës digjitale "UpTime" për menaxhimin e punonjësve, kohës së punës dhe detyrave të tyre. Platforma është ndërtuar me MERN Stack dhe përdor një sistem të avancuar të kontrollit të aksesit bazuar në role (RBAC), duke mbështetur administrimin e më shumë se një kompanie. Roli i "Super-Admin" mbikëqyr menaxhimin e kompanive dhe administratorëve, ndërsa "Admin" menaxhon punonjësit, detyrat dhe orarin e tyre të punës. "Employee" mund të regjistrojë orarin e punës, të ndjekë detyrat dhe të bëjë kërkesa për pushim.

Punimi analizon arkitekturën, funksionalitetet dhe teknologjitë e përdorura në zhvillimin e kësaj platforme, duke vlerësuar sfidat dhe përfitimet e saj. "UpTime" synon të rrisë efikasitetin e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe të automatizojë proceset e biznesit, duke ofruar një zgjidhje fleksibile dhe të shkallëzueshme për kompanitë moderne.

Abstract

This thesis deals with the development and implementation of the digital platform "UpTime" for managing employees, their working time and tasks. The platform is built with MERN Stack and uses an advanced role-based access control (RBAC) system, supporting the administration of more than one company. The "Super-Admin" role oversees the management of companies and administrators, while the "Admin" manages employees, their tasks and work schedules. The "Employee" can record work hours, track tasks and make leave requests.

This paper analyzes the architecture, functionalities and technologies used in the development of this platform, assessing its challenges and benefits. "UpTime" aims to increase the efficiency of human resource management and automate business processes, providing a flexible and scalable solution for modern companies.

Falënderime

Me mirënjohje të thellë, dua të shpreh falënderimet e mia më të sinqerta për të gjithë ata që më kanë mbështetur dhe inkurajuar gjatë këtij rrugëtimi akademik dhe profesional.

Një falënderim i veçantë i shkon familjes sime, e cila ka qenë gjithmonë mbështetja dhe forca ime më e madhe. Dashuria, durimi dhe mbështetja e tyre më kanë dhënë motivimin e nevojshëm për të kaluar çdo sfidë dhe për të arritur këtë moment të rëndësishëm.

Gjithashtu, dua të falënderoj profesorët e mi, të cilët me përkushtimin dhe udhëzimet e tyre më kanë ndihmuar të fitoj njohuri dhe aftësi të rëndësishme. Një falënderim i veçantë i shkon mentores sime, Profesoreshës Lindita Loku Nikçi, për mbështetjen, këshillat dhe udhëheqjen e saj të çmuar gjatë këtij rrugëtimi akademik. Ndihmesa dhe përkushtimi i saj kanë qenë një burim i madh motivimi dhe frymëzimi për mua.

Një falënderim i veçantë i shkon edhe kolegëve të mi, me të cilët kam ndarë sfida, përvoja dhe momente të rëndësishme gjatë këtij rrugëtimi. Mbështetja dhe bashkëpunimi i tyre kanë luajtur një rol të rëndësishëm në arritjet e mia.

Deklarata e studentit

Unë, Shëndrit Koprani, student në Universitetin Publik, Kadri Zeka, departamenti i Shkencave Kompjuterike, drejtimi Inxhinieri Softuerike dhe Web Dizajn, me numër të ID-së: 19071047 nën përgjegjësinë time deklaroj se ky punim i titulluar “Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime” është puna ime origjinale, nuk është prezantuar asnjëherë para një institucioni tjetër për vlerësim dhe nuk është publikuar askund. Të njëjtin nuk e kam kopjuar nga asnjë punim të studentëve tjerë, apo nga ndonjë burim tjetër përveç atyre burimeve të cituara në mënyrë të rregullt, apo i njëjti nuk ka qenë pjesë e ndonjë punimi të shkruar nga unë apo ndonjë person tjetër.

Përmbajtja

1	Hyrje	8
2	Teknologjitë e përdorura për UpTime	9
2.1	Backend - Node.js & Express.js.....	9
2.2	Baza e të dhënave - MongoDB (me Mongoose ORM)	10
2.3	Frontend - React (me Vite, TypeScript, Tailwind CSS, MUI, Ant Design dhe Redux) ...	10
2.4	Autentifikimi dhe Siguria.....	12
3	Modeli konceptual i UpTime.....	12
3.1	Modeli konceptual i Super-Admin.....	13
3.2	Modeli konceptual i Admin	14
3.3	Modeli konceptual i Employee.....	15
4	Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës – UpTime.....	16
4.1	Moduli Super-Admin.....	17
4.1.1	Forma për kyçje në Modulin Super Admin.....	19
4.1.2	Dashboard - Ballina	20
4.1.3	Companies – Kompanitë	21
4.1.4	Newsletter – Shërbimi i Njoftimeve.....	23
4.1.5	Contacts – Kontakti	23
4.1.6	Users – Përdoruesit.....	24
4.1.7	Profile – Profili	25
4.2	Moduli Admin.....	26
4.2.1	Forma për kyçje në Modulin Admin.....	28
4.2.2	Dashboard – Ballina	29
4.2.3	Employees – Punëtorët	29
4.2.4	Tasks – Detyrat	31
4.2.5	Company – Kompania	33
4.2.6	Leave Requests – Kërkesat për Pushim.....	34
4.2.7	Daily Reports – Raportet Ditore.....	35

4.2.8	Profile – Profili	36
4.3	Moduli Employee.....	37
4.3.1	Forma për kyçje në Modulin Employee	38
4.3.2	Dashboard – Ballina	39
4.3.3	Tasks – Detyrat	40
4.3.4	Work History – Historia e Punës	42
4.3.5	Company – Kompania	42
4.3.6	Daily Reports – Raportet Ditore.....	43
4.3.7	Leave Requests – Kërkesat për Pushime.....	44
4.3.8	Profile – Profili	45
5	Përfundimi	46
6	Referencat	47

Lista e figurave

Figura 1.	Modeli konceptual i UpTime	13
Figura 2.	Modeli konceptual në Modulin Super Admin	14
Figura 3.	Modeli konceptual i Modulit Admin	15
Figura 4.	Modeli konceptual i Modulit Employee.....	16
Figura 5.	Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime	17
Figura 6.	Forma për kyçje në Modulin Super Admin	20
Figura 7.	Ballina e Modulit Super Admin.....	21
Figura 8.	Companies në Modulin Super Admin	22
Figura 9.	Modifikimi i Kompanive në Modulin Super Admin.....	22
Figura 10.	Newsletter në Modulin Super Admin	23
Figura 11.	Contacts në Modulin Super Admin	24
Figura 12.	Users në Modulin Super Admin.....	24
Figura 13.	Modifikimi i përdoruesve në Modulin Super Admin	25
Figura 14.	Profili në Modulin Super Admin	26
Figura 15.	Forma për kyçje në Modulin Admin	28
Figura 16.	Baliina në Modulin Admin.....	29
Figura 17.	Employee në Moduli Admin	30

Figura 18. Modifikimi i të dhënave të punëtorit.....	31
Figura 19. Tasks në Modulin Admin.....	32
Figura 20. Krijimi i detyrës së re nga Admini	32
Figura 21. Modifikimi i detyrës ng Admini	33
Figura 22. Company në Modulin Admin.....	34
Figura 23. Leave Requests në Modulin Admin	35
Figura 24. Paraqitja e kërkesave nga Admini	35
Figura 25. Daily Reports tek Moduli Admin	36
Figura 26. Profili në Modulin Admin	37
Figura 27. Forma për kycje në Modulin Employee	39
Figura 28. Ballina në Modulin Employee.....	40
Figura 29. Tasks në Modulin Employee.....	41
Figura 30. Modifikimi i Detyrës në Modulin Employee.....	41
Figura 31. Work History në Modulin Employee.....	42
Figura 32. Company në Modulin Employee	43
Figura 33. Daily Reports në Modulin Employee	43
Figura 34. Leave Requests në Modulin Employee	44
Figura 35. Kërkesat për pushim në Modulin Employee	45
Figura 36. Profili në Modulin Employee.....	45

Lista e shkurtesave

MERN – MongoDB, Express.js, React.js, Node.js (Stack-u teknologjik i platformës).

RBAC – Role-Based Access Control (Sistem i menaxhimit të aksesit bazuar në role).

API – Application Programming Interface (Ndërfaqja e programimit të aplikacioneve).

UI/UX – User Interface / User Experience (Ndërfaqja dhe përvoja e përdoruesit).

Super-Admin – Administratori kryesor i platformës, menaxhon të gjitha kompanitë dhe përdoruesit.

Admin – Administratori i një kompanie specifike, menaxhon punonjësit dhe detyrat.

Employee – Punonjësi i kompanisë, që ndjek detyrat dhe regjistron orët e punës.

Clock-In – Procesi i regjistrimit të fillimit të punës nga një punonjës.

Clock-Out – Procesi i regjistrimit të përfundimit të punës nga një punonjës.

WorkLog – Regjistrimi i orëve të punës për çdo punonjës.

Task – Detyrat e caktuara për punonjësit nga Admini.

LeaveRequest – Kërkesa për pushim nga punonjësit.

1 Hyrje

Gjatë këtij punimi, do të analizojmë në detaje arkitekturën e sistemit, procesin e zhvillimit të platformës, sfidat teknike të hasura dhe përfitimet e implementimit të saj. Do të diskutohen gjithashtu teknologjitë e përdorura në front-end dhe back-end, si dhe mënyra se si këto teknologji kontribuojnë në ndërtimin e një sistemi të sigurt, fleksibël dhe të shkallëzueshëm për menaxhimin e punonjësve. Me rritjen e kompleksitetit të operacioneve të biznesit dhe shtimin e kërkesave për menaxhim efikas të punonjësve, kompanitë janë gjithnjë e më shumë të orientuara drejt zgjidhjeve teknologjike për automatizimin e proceseve të tyre të punës. Menaxhimi i burimeve njerëzore nuk kufizohet vetëm në regjistrimin e orëve të punës apo caktimin e detyrave, por përfshin gjithashtu monitorimin e performancës, optimizimin e proceseve të punës dhe sigurimin e një komunikimi efektiv ndërmjet punonjësve dhe administratës.

Ky punim diplome paraqet zhvillimin dhe implementimin e "UpTime", një platforme të centralizuar për menaxhimin e punonjësve, orarit të punës dhe detyrave të tyre. Platforma është ndërtuar duke përdorur teknologjinë MERN Stack, e cila përfshin MongoDB, Express.js, React.js dhe Node.js, duke garantuar performancë të lartë, shkallëzueshmëri dhe një ndërfaqe moderne për përdoruesit. Një veçori e rëndësishme e platformës është kontrolli i aksesit bazuar në role (RBAC), që siguron qasje të diferencuar për përdoruesit sipas rolit të tyre në sistem. Për realizimin e këtij punimi, gjithashtu është përdorur një template i gatshëm i marrë nga MUI (Material UI) dhe është përshtatur për përdorimin në platformën tonë, duke siguruar një ndërfaqe moderne, intuitive dhe funksionale për përdoruesit (MaterialUI, 2025).

Platforma është strukturuar në tre module kryesore: Super-Admin, Admin dhe Employee. Super-Admin është përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e kompanive dhe administratorëve të tyre, Admin menaxhon punonjësit, detyrat dhe oraret e punës, ndërsa Employee mund të regjistrojë kohën e punës, të ndjekë detyrat dhe të paraqesë kërkesa për pushim. Kjo ndarje e qartë e roleve mundëson një menaxhim më të organizuar dhe efikas të burimeve njerëzore, duke reduktuar gabimet dhe duke optimizuar produktivitetin e punonjësve.

Përmes këtij punimi, do të analizojmë në detaje arkitekturën e platformës, metodologjitë e përdorura gjatë zhvillimit të saj, sfidat e hasura gjatë implementimit dhe përfitimet që "UpTime" ofron për bizneset. Do të diskutohet gjithashtu ndikimi i përdorimit të teknologjive moderne në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe mundësitë e zgjerimit të funksionaliteteve të platformës në të ardhmen.

2 Teknologjitë e përdorura për UpTime

UpTime është një web aplikacioni për menaxhimin e punonjësve brenda kompanisë i krijuar për të ndihmuar kompanitë të gjurmojnë orët e punës së punonjësve, të menaxhojnë detyrat dhe të trajtojnë kërkesat të ndryshme. Platforma i jep përparësi shkallëzueshmërisë, performancës dhe përvojës së përdoruesit, duke i lejuar administratorët të menaxhojnë aktivitetet e punëtorëve pa probleme, ndërsa u siguron punonjësve një ndërfaqe intuitive për regjistrimin e orëve të punës dhe trajtimin e detyrave. Për të ndërtuar UpTime, është përdorur grupi MERN (MongoDB, Express.js, React, Node.js) me TypeScript, Vite, Tailwind CSS, Material UI (MUI), Ant Design (AntD) dhe Redux për menaxhimin e gjendjes.

2.1 Backend - Node.js & Express.js

Backend është përgjegjës për trajtimin e vërtetimit, logjikës së biznesit dhe ndërveprimeve të bazës së të dhënave. Përdorimi i Node.js me Express.js është bërë për disa arsye që janë cekur më poshtë.

Node.js

- I/O asinkrone dhe jo bllokuese: Trajton me efikasitet kërkesat e shumta të njëkohshme, duke e bërë atë ideal për aplikacione në kohë reale si gjurmimi i kohës së punonjësve.
- Gjuhë e vetme e programimit (JavaScript/TypeScript): Mundëson zhvillimin e pandërprerë të grupit të plotë me të njëjtën gjuhë si në pjesën e përparme ashtu edhe në pjesën e pasme.
- Shkallueshmëria: Mbështet arkitekturën e mikrosërbyeve nëse nevojitet për përmirësime të ardhshme.
- Ekosistemi i madh: Një koleksion i madh bibliotekash dhe kornizash me burim të hapur përshpejton zhvillimin (Node.js, (n.d)).

Express.js

- I lehtë dhe i shpejtë: Një kornizë minimale dhe fleksibël për ndërtimin e API-ve RESTful.
- Mbështetja e Middleware: Thjeshton trajtimin e kërkesave me softuer të integruar dhe të palëve të treta.
- Sistemi efikas i rrugëtimit: Siguron strukturë të organizuar dhe të mirëmbajtur API.
- Integrimi me JWT: Ndihmon në menaxhimin e sigurt të vërtetimit dhe autorizimit (Express.js, n.d).

Karakteristikat kryesore të zbatuara janë: Kontrolli i aksesit i bazuar në role (RBAC) për menaxhimin e autorizimeve të super-administratorit, administratorit dhe përdoruesit, dizajni RESTful API për të siguruar modularitet dhe shkallëzim dhe softueri i mesëm për regjistrimin, vërtetimin dhe trajtimin e gabimeve për të përmirësuar sigurinë dhe mirëmbajtjen.

2.2 Baza e të dhënave - MongoDB (me Mongoose ORM)

Zgjedhja e MongoDB është bërë pasi që është i shkëlqyeshëm për aplikacione fleksibël, të shkallëzuar dhe me performancë të lartë. Struktura e saj pa skema dhe e bazuar në dokumente e bën atë ideal për trajtimin e të dhënave të mëdha dhe dinamike. Ai mbështet shkallëzimin horizontal, pyetjet në kohë reale dhe integrimin e lehtë me aplikacionet moderne.

MongoDB

- **Fleksibiliteti NoSQL:** Natyra pa skema lejon përditësime dinamike të strukturave të të dhënave të punonjësve dhe kompanisë pa modifikime strikte të tabelës.
- **Shkallueshmëria:** MongoDB mund të trajtojë sasi të mëdha të të dhënave në mënyrë efikase me ndarjen dhe përsëritjen.
- **Ruajtja e dokumenteve si JSON:** Funksionon mirë me aplikacionet e bazuara në JavaScript/TypeScript, duke reduktuar shpenzimet e përgjithshme të transformimit.

Mongoose ORM

- **Përkufizimi i skemës:** Ndhmon në ruajtjen e të dhënave të strukturuar edhe në një bazë të dhënash NoSQL.
- **Validimi i integruar i të dhënave:** Redukton gabimet dhe forcon logjikën e biznesit. Mbështetja e Middleware: Lejon grepa para dhe pas ruajtjes për përpunim logjik shtesë.
- **Optimizimi i pyetjeve:** Mundëson operacione efikase të indeksimit dhe kërkimit.

2.3 Frontend - React (me Vite, TypeScript, Tailwind CSS, MUI, Ant Design dhe Redux)

Frontend është krijuar për një përvojë të shpejtë, të përgjegjshme dhe të mirëmbajtur të përdoruesit.

React

- Arkitektura e bazuar në komponentë: Inkurajon ripërdorimin dhe zhvillimin modular të ndërfaqes së përdoruesit.
- Menaxhimi efikas i gjendjes: Mund të integrohet lehtësisht me Redux për menaxhimin e gjendjes globale.
- Virtual DOM: Përmirëson performancën duke minimizuar manipulimet e drejtpërdrejta të DOM.
- Mbështetje e fortë e ekosistemeve dhe komunitetit: Siguron përmirësim të vazhdueshëm dhe akses në bibliotekat e palëve të treta (React., n.d).

Vite

- Ndërton zhvillim të shpejtë: Vite redukton ndjeshëm kohën e fillimit të zhvillimit.
- Zëvendësimi i modulit (HMR): Lejon përditësime të menjëhershme të ndërfaqes së përdoruesit gjatë zhvillimit (Vite, n.d).

TypeScript

- Siguria e llojit: Redukton gabimet e kohës së ekzekutimit duke zbatuar kontrollet e tipit të variablave të përdorura.
- Lexueshmëria dhe mirëmbajtja e përmirësuar e kodit: Ndihmon me dokumentacion dhe korrigjimin më të mirë.
- Përfundimi automatik dhe Inteligjenca: Rrit produktivitetin e zhvilluesit (TypeScript, n.d).

Tailwind CSS

- Utility-First Approach: Mundëson zhvillimin e shpejtë të UI me stile të paracaktuara.
- Bloat minimale CSS: Përfshin vetëm stilet e nevojshme, duke bërë që faqet të ngarkohen më shpejt.
- Dizajn i përgjegjshëm jashtë kutisë: Përshtatet lehtësisht me madhësi të ndryshme të ekranit (Tailwind, n.d).

Material UI (MUI) dhe Ant Design (AntD)

- Komponentët e ndërfaqes: Kursen kohën e zhvillimit me komponentë modernë, tërheqës vizualisht.
- Përshtatshmëria: Mbështet personalizimin e temës për t'iu përshtatur markës së platformës.
- Ant Design për ndërfaqet e administratorit: Ofron elementë të strukturuar të ndërfaqes së përdoruesit që përmirësojnë përvojën e përdoruesit në pultin e administratorit.
- MUI për elementet interaktive: Përdoret për butona, forma, modale dhe komponentë miqësorë për përdoruesit (MUI, n.d; Design, n.d).

Redux

- Trajtimi efikas i të dhënave: Redukton rikthimet e panevojshme duke përditësuar në mënyrë selektive UI.
- Menaxhimi i gjendjes globale: Lehtëson ndarjen e të dhënave midis komponentëve dhe e bën më të lehtë gjurmimin e ndryshimeve në gjendjen e aplikacionit (Redux, n.d.).

2.4 Autentifikimi dhe Siguria

Pasi që menaxhimi i punonjësve përfshin të dhëna të ndjeshme, janë përfshirë masa të fuqishme vërtetimi dhe sigurie.

Metodat e përdorura të verifikimit janë:

- JWT (JSON Web Tokens) për menaxhimin e sesioneve.
- Kontrolli i aksesit i bazuar në role (RBAC) për trajtimin e lejeve
- bcrypt për hashimin e fjalëkalimit.

Masat shtesë të sigurisë:

- Helmet.js: Shton header-a sigurie për të parandaluar sulmet XSS dhe Clickjacking.
- CORS Middleware: Siguron qasje të sigurt në API nga burime të ndryshme.
- Kufizimi i Shpejtësisë (Rate Limiting): Parandalon përpjekjet e shumta për hyrje me forcë brutale.
- Zbatimi i HTTPS: Siguron të gjithë komunikimin midis klientit dhe serverit.

3 Modeli konceptual i UpTime

Modeli konceptual tregon strukturën e platformës për menaxhimin e punonjësve, kohës së punës dhe detyrave të punës - UpTime dhe ndarjen e saj në tre module kryesore:

1. **Super-Admin** – Roli me nivelin më të lartë të aksesit. Super-Admin menaxhon të gjitha kompanitë në sistem, krijon dhe menaxhon administratorët e kompanive.
2. **Admin** – Administratori i një kompanie specifike. Admini menaxhon punonjësit, cakton detyrat, monitoron orarin e punës dhe miraton kërkesat për pushim.
3. **Employee** – Punonjësi i kompanisë, i cili regjistron orarin e punës (Clock-In/Clock-Out), ndjek detyrat e caktuara dhe mund të bëjë kërkesa për pushim.




Figura 1. Modeli konceptual i UpTime

Në figurën më lart është paraqitur diagrami që e ndan UpTime si një entitet qendror, nga i cili burojnë tre module kryesore që përcaktojnë funksionalitetet dhe rolet e përdoruesve në sistem.

3.1 Modeli konceptual i Super-Admin

Modeli konceptual i Super-Admin përfaqëson rolin më të lartë në platformën UpTime, i cili ka kontroll të plotë mbi sistemin. Super-Admin është përgjegjës për krijimin dhe menaxhimin e kompanive, caktimin e administratorëve (Admin) për secilën kompani dhe mbikëqyrjen e përdoruesve dhe rregullave të sistemit. Ai ndërvepron me entitetet Dashboard, Companies, Newsletter, Contacts, Users dhe Profile duke siguruar që çdo kompani të ketë një administrator

dhe të funksionojë sipas politikave të platformës. Gjithashtu, ai ka akses në monitorimin e aktiviteteve të përdoruesve dhe administrimin e politikave të sigurisë për të garantuar funksionimin e qëndrueshëm të sistemit.



Figura 2. Modeli konceptual në Modulin Super Admin

3.2 Modeli konceptual i Admin

Modeli konceptual i Admin përfaqëson administratorin e një kompanie specifike brenda platformës UpTime. Admin është përgjegjës për menaxhimin e punonjësve, caktimin dhe monitorimin e detyrave, aprovimin ose refuzimin e kërkesave për pushim dhe mbikëqyrjen e orëve të punës të punonjësve. Ai ndërvepron me entitetet Dashboard, Employees, Tasks, Company, LeaveRequest dhe Profile duke siguruar që çdo proces i punës të jetë i organizuar dhe efikas. Admin luan një rol kyç në optimizimin e produktivitetit të kompanisë, duke menaxhuar operacionet e brendshme në mënyrë efektive.



Figura 3. Modeli konceptual i Modulit Admin

3.3 Modeli konceptual i Employee

Modeli konceptual i Employee përfaqëson punonjësin e një kompanie brenda platformës UpTime. Employee është përgjegjës për regjistrimin e orarit të punës, përmbushjen e detyrave të caktuara nga Admin dhe dërgimin e kërkesave për pushim. Ai ndërvepron me entitetet Dashboard, Task, Work History, Company, Daily Reports, Leave Request dhe Profile duke mundësuar një menaxhim të qartë të angazhimeve të tij të punës. Ky modul siguron që punonjësi të ketë një pasqyrë të plotë të detyrave dhe orarit të tij, duke kontribuar në efikasitetin dhe organizimin e punës brenda kompanisë.




Figura 4. Modeli konceptual i Modulit Employee

4 Platforma Digjitale per Menaxhimin e Procesit të Punës – UpTime

UpTime është një platformë digjitale e ndërtuar mbi MERN Stack, e cila ofron një zgjidhje të plotë për menaxhimin e punonjësve, kohës së punës dhe detyrave të punës. Ajo organizon përdoruesit në tre role kryesore: Super-Admin i cili menaxhon kompanitë dhe administratorët, Admin që menaxhon punonjësit, detyrat dhe oraret e punës dhe Employee që regjistron orarin e punës, përmbush detyrat, aplikon për pushime dhe shkruan raporte ditore. Platforma përfshin funksionalitete si regjistrimi i orarit të punës (Clock-In & Clock-Out), menaxhimi i detyrave, administrimi i kërkesave për pushim dhe gjenerimi i raporteve mbi performancën. Me një sistem të fuqishëm të menaxhimit të aksesit (RBAC), ajo siguron efikasitet, transparencë dhe automatizim të plotë të proceseve të punës. UpTime është fleksibël dhe e shkallëzueshme, duke u përshtatur me nevojat e kompanive të çdo madhësie për të optimizuar organizimin dhe produktivitetin e stafit të tyre. Platforma gjithashtu përmban një faqe hyrëse ku përdoruesit mund të shfletojnë dhe të informohen mbi funksionalitetet e saj. Kjo faqe përmban menytë kryesore Clients, About Us, FAQs dhe Contact. Seksioni Clients shfaq klientët e platformës UpTime, About Us përmban informacione rreth kompanisë UpTime, ndërsa FAQs përmbledh

pyetjet më të shpeshta që lidhen me përdorimin e platformës. Seksioni Contact u mundëson përdoruesve të kontaktojnë Super-Adminin për ndihmë ose informacione shtesë. Përveç këtyre, në këtë faqe përdoruesit kanë mundësinë të abonohen (Subscribe) për të marrë njoftime dhe informacione të rëndësishme mbi zhvillimet e platformës.




Figura 5. Platforma Digjitale për Menaxhimin e Procesit të Punës - UpTime

4.1 Moduli Super-Admin

Moduli Super-Admin është niveli më i lartë i administrimit në platformën UpTime dhe ka akses të plotë mbi të gjitha funksionet e sistemit. Ky modul është përgjegjës për menaxhimin e platformës, duke mbikëqyrur kompanitë, administratorët e tyre dhe rregullat e përgjithshme të sistemit. Super-Admin është përdoruesi që mund të krijojë, konfigurojë dhe kontrollojë të gjitha operacionet kryesore në sistem. Ai është përgjegjës për mirëmbajtjen e strukturës organizative, sigurinë e të dhënave, monitorimin e aktivitetit dhe konfigurimet teknike të platformës.

Funksionalitetet kryesore të Modulit Super-Admin:

1. Menaxhimi i Kompanive

Një nga detyrat kryesore të Super-Admin është menaxhimi i kompanive të regjistruara në platformë. Ai ka të drejtë të:

- Krijojë kompani të reja, duke regjistruar emrin, sektorin e industrisë dhe administratorin përkatës (si dhe fushat e tjera të nevojshme).
- Modifikojë të dhënat e kompanisë, duke përditësuar informacionin mbi strukturën dhe konfigurimin e saj.

- Pezullojë ose fshijë kompani që nuk janë më aktive ose që nuk ndjekin politikat e platformës.

2. Menaxhimi i Përdoruesve dhe Roleve

Super-Admin është përgjegjës për administrimin e përdoruesve dhe rolit të tyre brenda sistemit. Kjo përfshin:

- Krijimin e administratorëve të rinj (Admin) për kompanitë e reja.
- Menaxhimin e aksesit të përdoruesve, duke përcaktuar privilegjet dhe kufizimet për çdo rol (Super-Admin, Admin, Employee).
- Fshirjen ose pezullimin e përdoruesve në rast se ata nuk janë më aktivë ose nëse ka shkelje të politikave të platformës.

3. Monitorimi dhe Auditim i Aktivitetit

Super-Admin ka një panel të detajuar të monitorimit, ku ai mund të shohë:

- Listën e kompanive aktive dhe administratorëve të tyre.
- Numrin e punonjësve të regjistruar për çdo kompani.
- Historikun e aktiviteteve të Administratorëve dhe Punonjësve.

4. Menaxhimi i Rregullave të Platformës

Super-Admin ka aftësinë të përcaktojë rregulla të përgjithshme që zbatohen për të gjitha kompanitë e regjistruara në platformë. Këto rregulla përfshijnë:

- Përcaktimin e orarit të punës për kompanitë (p.sh., 08:00 - 16:00, 09:00 - 17:00).
- Konfigurimin e metodave të gjenerimit të raporteve, për t'u siguruar që çdo kompani ka një pamje të qartë mbi performancën e punonjësve.

5. Menaxhimi i Sistemit dhe Infrastrukturës

Si administratori më i lartë i platformës, Super-Admin ka akses në konfigurimet teknike dhe të sigurisë së sistemit. Ai mund të:

- Përcaktojë politikat e sigurisë për hyrjen në platformë.
- Monitorojë përdorimin e burimeve të sistemit, për të siguruar performancën dhe stabilitetin e tij.
- Përditësojë sistemin, duke siguruar që platforma të jetë gjithmonë e përditësuar me veçoritë dhe përmirësimet më të fundit.

- Menaxhojë API-t dhe integrimet me sisteme të tjera, në rast se platforma duhet të lidhet me softuerë të tjerë për menaxhimin e burimeve njerëzore.

6. Siguria dhe Akseset

Super-Admin ka rolin e garantuesit të sigurisë së të dhënave brenda platformës. Kjo përfshin:

- Menaxhimin e autentikimit dhe autorizimit, duke siguruar që vetëm përdoruesit e autorizuar të kenë akses në informacione të ndjeshme.
- Monitorimin e hyrjeve në sistem për të zbuluar aktivitetet e dyshimta dhe për të parandaluar sulmet kibernetike.
- Ruajtjen dhe rikthimin e të dhënave (Data Backup & Recovery), për të garantuar që informacioni i rëndësishëm të mos humbasë në rast të një problemi teknik.

4.1.1 Forma për kyçje në Modulin Super Admin

Në modulin Super-Admin, forma e kyçjes i mundëson administratorit kryesor të platformës të ketë akses në menaxhimin e përgjithshëm të sistemit, duke përfshirë administrimin e kompanive, përdoruesve dhe rregullave të platformës. Menyja e kyçjes në këtë modul përmban hapësira për të shkruar emailin dhe fjalëkalimin, duke mundësuar identifikimin e përdoruesve sipas rolit të tyre. Në rast se një nga këto të dhëna shënohet gabim, shfaqet një mesazh që informon përdoruesin se kredencialet nuk janë të sakta dhe se nuk mund të kyçet. Gjithashtu, forma përmban validimin e të dhënave për të siguruar që fusha e emailit dhe fjalëkalimit të jenë të plotësuara siç duhet. Kyçja e sigurt siguron që vetëm personat e autorizuar të kenë kontroll të plotë mbi funksionalitetet e avancuara të sistemit.




Figura 6. Forma për kyçje në Modulën Super Admin

4.1.2 Dashboard - Ballina

Dashboard apo Ballina e Super-Admin në platformën UpTime ofron një përmbledhje të përgjithshme mbi aktivitetin dhe statistikën kryesore të sistemit. Në këtë seksion shfaqet numri total i kompanive të regjistruara, si dhe ndarja e tyre në kompani aktive dhe joaktive. Gjithashtu, Super-Admin mund të shohë numrin e përdoruesve të regjistruar, duke i ndarë në përdorues aktivë dhe joaktivë. Përveç kësaj, ballina përfshin informacion mbi numrin total të detyrave të dhëna në sistem dhe numrin e përgjithshëm të përdoruesve të abonuar në buletin informativ. Ky seksion i siguron Super-Admin një pasqyrë të qartë mbi funksionimin e platformës dhe ndihmon në monitorimin dhe administrimin më efikas të kompanive dhe përdoruesve.




Figura 7. Ballina e Modulit Super Admin

4.1.3 Companies – Kompanitë

Companies apo Kompanitë në modulën Super-Admin ofron një pasqyrë të detajuar mbi të gjitha kompanitë e regjistruara në platformën UpTime. Në këtë seksion shfaqet numri total i kompanive, duke përfshirë ato aktive dhe joaktive. Për çdo kompani të regjistruar, paraqitet një listë me informacionet kryesore si ID-ja e kompanisë, emri, përshkrimi, uebsajti, emaili, statusi dhe numri i punonjësve. Gjithashtu, për secilën kompani janë të listuara ditët e punës dhe statusi i saj operativ. Super-Admin ka mundësinë të menaxhojë kompanitë duke ndryshuar të dhënat, duke shtuar ose fshirë administratorët e kompanive dhe duke bërë modifikime sipas nevojës. Ky seksion siguron një administrim të plotë dhe efikas të kompanive, duke lehtësuar monitorimin dhe organizimin e tyre në sistem.




Figura 8. Companies në Modulin Super Admin

Në figurën më poshtë është paraqit dritarja e cila hapet e cila bënë modifikimin e kompanive. Këtu mund të ndryshohen të dhënat e kompanisë së caktuar si dhe mund të fshihet ajo kompani duke kaluar në kompani jo aktive.




Figura 9. Modifikimi i Kompanive në Modulin Super Admin

4.1.4 Newsletter – Shërbimi i Njoftimeve

Newsletter në modulën Super-Admin ofron një listë të detajuar të përdoruesve që janë abonuar për të marrë njoftime dhe informacione nga platforma UpTime. Në këtë seksion shfaqen të dhënat e abonentëve, përfshirë ID-në e tyre, adresën e emailit dhe datën kur është bërë abonimi. Për administrimin më të lehtë, ekziston një buton që mundëson fshirjen e abonentëve në rast nevojë. Gjithashtu, është i disponueshëm një filtër që ndihmon në kërkimin dhe gjetjen e shpejtë të përdoruesve të abonuar, duke lehtësuar menaxhimin e bazës së të dhënave të abonentëve. Ky seksion siguron një organizim të thjeshtë dhe efikas të listës së abonimeve.




Figura 10. Newsletter në Modulën Super Admin

4.1.5 Contacts – Kontakti

Contacts apo Kontakti në modulën Super-Admin shërben për menaxhimin e mesazheve të marra përmes formularit të kontaktit në platformën UpTime. Ky seksion përmban informacionin e personave që kanë kontaktuar, duke përfshirë ID-në, emrin, mbiemrin, adresën e emailit, numri e telefonit, titullin dhe përshkrimin e mesazhit të tyre. Për lehtësinë e administrimit, është i disponueshëm një buton që mundëson fshirjen e kontaktuesve sipas nevojës. Gjithashtu, për të gjetur më shpejt një kontakt të caktuar, platforma ofron një filtër kërkimi, duke e bërë më të thjeshtë menaxhimin dhe organizimin e mesazheve. Ky seksion ndihmon në mbajtjen e një komunikimi të strukturuar dhe efikas me përdoruesit e platformës.




Figura 11. Contacts në Modulën Super Admin

4.1.6 Users – Përdoruesit

Menyja Users në modulën Super-Admin përmban një listë të detajuar të të gjithë përdoruesve të regjistruar në platformën UpTime, duke përfshirë emrin e përdoruesit, adresën e emailit, rolin e tij në sistem dhe kompaninë me të cilën është i lidhur. Ky seksion i mundëson Super-Adminin të menaxhojë përdoruesit në mënyrë efikase, duke ofruar funksionalitete si krijimi i përdoruesve të rinj, modifikimi i të dhënave ekzistuese dhe fshirja e përdoruesve nga sistemi nëse është e nevojshme. Përmes këtij moduli, Super-Admini ka kontroll të plotë mbi strukturën e përdoruesve në platformë, duke siguruar një menaxhim të organizuar dhe të rregullt të të dhënave të përdoruesve të regjistruar.




Figura 12. Users në Modulën Super Admin

Në figureën më poshtë është paraqitur faqja e cila hapet kur klikojmë tek butoni per modifikimin e te dhënave. Kjo formë na mundëson t'i modifikojmë të dhënat e përdoruesve të regjistruar.

The screenshot shows the 'Edit User' interface within the UpTime Super Admin module. On the left is a sidebar with navigation links: Dashboard, Companies, Newsletter, Contacts, Users, Profile, About, and Feedback. The main content area is titled 'Edit User' and contains a form with the following fields: 'Name' (pre-filled with 'BTECHCorp asd'), 'Role' (a dropdown menu currently showing 'Admin'), and 'New Password (optional)' (with a note 'Leave blank to keep the current password'). A green 'Update User' button is at the bottom of the form. The footer of the page includes the text 'Copyright © UpTime 2025.' and a user profile for 'SuperAdmin' with the email 'admin@uptime.com'.

Figura 13. Modifikimi i përdoruesve në Modulin Super Admin

4.1.7 Profile – Profili

Profile apo Profili në modulin Super-Admin shfaq informacionin e profilit të Super-Adminit, duke ofruar një hapësirë të dedikuar për menaxhimin e llogarisë personale. Në këtë seksion, Super-Admin ka mundësinë të ndryshojë vetëm fjalëkalimin e tij për siguri më të lartë. Ndryshimi i fjalëkalimit bëhet përmes një forme të thjeshtë dhe të sigurt, duke kërkuar fjalëkalimin aktual dhe atë të ri. Ky seksion siguron një mënyrë të shpejtë dhe efikase për ruajtjen e sigurisë së llogarisë së Super-Adminit në platformën UpTime.




Figura 14. Profili në Modulin Super Admin

4.2 Moduli Admin

Moduli Admin është një nga tre modulet kryesore të platformës UpTime, i cili përfaqëson administratorin e një kompanie të veçantë. Admin ka akses të kufizuar në platformë krahasuar me Super-Admin, por është përgjegjës për menaxhimin e punonjësve, detyrave, kohës së punës dhe kërkesave për pushim brenda kompanisë që ai administron.

Funksionalitetet e Modulit Admin janë këto:

1. Menaxhimi i Punonjësve

Një nga përgjegjësitë kryesore të Admin është menaxhimi i punonjësve të kompanisë së tij.

Kjo përfshin:

- Shtimin e punonjësve të rinj në sistem.
- Menaxhimin e aksesit të punonjësve në platformë.
- Fshirjen ose pezullimin e punonjësve, në rast të largimit nga kompania

2. Caktimi dhe Menaxhimi i Detyrave

Admini ka aftësinë të:

- Krijojë dhe caktojë detyra për punonjësit e tij.
- Monitorojë përparimin e detyrave dhe të ndjekë afatet kohore.

- Modifikojë ose fshijë detyrat, nëse është e nevojshme.
- Ndajë prioritetin e detyrave, duke caktuar ato që janë më urgjente.

3. Monitorimi i Kohës së Punës (Work Log)

Admini është përgjegjës për mbikëqyrjen e orëve të punës të punonjësve dhe ka akses në:

- Orët e regjistruara nga punonjësit (Clock-In / Clock-Out).
- Raportet e kohës së punës për çdo punonjës.
- Verifikimin e kohës së punës së deklaruar, duke siguruar që punonjësit po respektojnë orarin.

4. Menaxhimi i Kërkesave për Pushim

Admini mund të:

- Pranojë ose refuzojë kërkesat për pushim nga punonjësit.
- Monitorojë ditët e pushimit të përdorura nga çdo punonjës.
- Konfirmojë nëse një punonjës ka të drejtë për pushim, bazuar në politikat e kompanisë.

5. Gjenerimi i Raporteve

Admini mund të krijojë raporte të ndryshme për të vlerësuar performancën e punonjësve dhe ecurinë e kompanisë, duke përfshirë:

- Raporte mbi kohën e punës (sa orë ka punuar çdo punonjës gjatë një periudhe të caktuar).
- Raporte mbi performancën e detyrave (cilat detyra janë përfunduar dhe cilat janë të mbetura).

4.2.1 Forma për kyçje në Modulin Admin

Në modulin Admin, forma e kyçjes lejon administratorët e kompanive të identifikohen dhe të menaxhojnë punonjësit, detyrat dhe orarin e punës. Menyja e kyçjes në këtë modul përmban hapësira për të shkruar emailin dhe fjalëkalimin, duke mundësuar identifikimin e përdoruesve sipas rolit të tyre. Në rast se një nga këto të dhëna shënohet gabim, shfaqet një mesazh që informon përdoruesin se kredencialet nuk janë të sakta dhe se nuk mund të kyçet. Gjithashtu, forma përmban validimin e të dhënave për të siguruar që fusha e emailit dhe fjalëkalimit të jenë të plotësuara siç duhet. Kyçja e saktë është e rëndësishme për të ruajtur sigurinë e të dhënave dhe për të siguruar akses vetëm për administratorët e autorizuar.


The image shows a login form for 'uptime' with the tagline 'time matters'. The form is titled 'Sign In' and contains fields for 'Email' (with the example 'admin@admin.com') and 'Password' (masked with dots). There is a 'Forgot Password?' link and a green 'Sign In' button. At the bottom, it says 'Dont have an account? Resgister your company [here.](#)'.

Figura 15. Forma për kyçje në Modulin Admin

4.2.2 Dashboard – Ballina

Ballina e modulit Admin në platformën UpTime ofron një pasqyrë të përgjithshme mbi gjendjen e kompanisë dhe detyrave të punonjësve. Në këtë seksion shfaqet numri total i punonjësve të kompanisë, duke i dhënë administratorit një pamje të qartë mbi strukturën e stafit. Gjithashtu, ekziston një hapësirë e dedikuar për menaxhimin e detyrave, ku detyrat shfaqen të organizuara sipas statusit të tyre: Detyrat në pritje, Detyrat në proces dhe Detyrat e përfunduara. Kjo ndarje ndihmon administratorin të monitorojë përparimin e detyrave dhe të marrë masa për optimizimin e punës në kompani. Ky seksion e bën më të lehtë dhe efikase menaxhimin e stafit dhe detyrave brenda kompanisë.




Figura 16. Ballina në Modulin Admin

4.2.3 Employees – Punëtorët

Employees në modulën Admin shfaq listën e punonjësve të kompanisë së administruar, duke përfshirë të dhënat kryesore si ID, emri dhe emaili i tyre. Për lehtësinë e kërkimit, është i disponueshëm një filtër kërkimi, i cili ndihmon në gjetjen e shpejtë të një punonjësi të caktuar. Admini ka mundësinë të shtojë punonjës të rinj të cilët njoftohen me email pasi të regjistrohen nga Admini në një kompani të caktuar, ku në email punëtorit i dërgohet email adresa dhe passwordi që mund të përdor për tu kyçur në sistem. Admini mund të ndryshojë të dhënat e një punonjësi ekzistues, si dhe të shikojë kohën e punës së regjistruar nga ai punonjës. Gjithashtu, në këtë seksion admini mund të gjenerojë raportin e punonjësit, duke marrë një analizë të detajuar mbi aktivitetin e tij në kompani. Për gjenerimin e raportit, admini duhet të zgjedhë një

muaj të caktuar, dhe më pas platforma krijon një raport të detajuar të punës së punonjësit për atë periudhë kohore. Në rast nevojë, admini ka gjithashtu mundësinë të fshijë një punonjës nga sistemi, duke menaxhuar në mënyrë efektive strukturën e stafit të kompanisë. Ky seksion ndihmon në administrimin e plotë dhe të organizuar të punonjësve brenda platformës UpTime.




Figura 17. Employee në Moduli Admin

Në këtë figurë është treguar faqja e cila hapet kur klikojmë në butonin për modifikimin e të dhënave të një punëtori. Në këtë pjesë mund të editohen të dhënat e punëtorit, mund të fshihet punëtori, të bëhet gjenerimi i raportit mujor si dhe Admini mund të shohë orët e punës së punëtorit të regjistruara me ClockIn dhe ClockOut.




Figura 18. Modifikimi i të dhënave të punëtorit

4.2.4 Tasks – Detyrat

Tasks apo Detyrat në modulën Admin shfaq të gjitha detyrat e caktuara për punonjësit, të organizuara sipas statusit të tyre: Detyrat në pritje, Detyrat në proces dhe Detyrat e përfunduara. Për secilën detyrë, admini mund të shohë datën kur është caktuar, prioritetin, përshkrimin dhe të bëjë komente për komunikim të drejtpërdrejtë me punonjësit. Në këtë seksion admini gjithashtu mund të krijojë detyra të reja përmes butonit "Create New Task", i cili hap një dritare për regjistrimin e detyrës së re. Gjatë krijimit të një detyre, admini mund të vendosë titullin, përshkrimin, prioritetin, punonjësin përgjegjës dhe datën e dorëzimit. Ky seksion ndihmon në shpërndarjen e qartë të detyrave dhe ndjekjen e progresit të punës në kompani, duke mundësuar një menaxhim efikas të stafit dhe produktivitetit.




Figura 19. Tasks në Modulin Admin

Në figurën më poshtë është paraqitur dritarja për krijimin e detyrave nga Admini për Punëtorët. Me klikimin e butonit Create New Task hapet dritarja ku Admini shënon titullin e detyrës, përshkrimin e detyrës, cakton statusin e saj, prioritetin, datën kur është dhënë detyra dhe caktohet punëtori të cilit i drejtohet detyra.




Figura 20. Krijimi i detyrës së re nga Admini

Figura më poshtë shfaq dritaren e cila hapet pasi të klikohet butoni për modifikimi e prioritetin të detyrës, duke e kaluar atë nga një detyrë në pritje në një detyrë në progres apo një detyrë të kryer. Në këtë pjesë mund të shënohen komente nga Admini për Punëtorin, si dhe Admini mund të bëjë fshirjen e komenteve të bëra.




Figura 21. Modifikimi i detyrës ng Admini

4.2.5 Company – Kompania

Company apo Kompania në modulën Admin shfaq informacionin e detajuar të kompanisë, duke përfshirë emrin, llojin e kompanisë, adresën, faqen e internetit, kontaktin, numrin e punonjësve dhe statusin e saj. Përveç këtyre të dhënave, në këtë seksion admini ka qasje edhe në rregullat e kompanisë, si ditët e punës dhe oraret e punës për çdo ditë. Kjo meny i mundëson administratorit të ketë një pasqyrë të qartë të konfigurimit dhe funksionimit të kompanisë, duke ndihmuar në menaxhimin dhe përshtatjen e politikave të punës sipas nevojave të stafit dhe organizatës.




Figura 22. Company në Modulin Admin

4.2.6 Leave Requests – Kërkesat për Pushim

Leave Requests apo Kërkesat për Pushim në modulin Admin lejon administrimin e kërkesave për pushim të dërguara nga punonjësit. Në këtë seksion, admini mund të shohë të gjitha kërkesat e paraqitura, duke përfshirë emrin e punonjësit, arsyen e pushimit, datën e fillimit dhe mbarimit të pushimit, llojin e pushimit (si pushim vjetor, pushim personal, etj.), si dhe kohëzgjatjen e pushimit. Admini ka mundësinë të aprovojë ose refuzojë një kërkesë për pushim dhe, në rast refuzimi, mund të shënojë arsyen e refuzimit. Gjithashtu, nëse është e nevojshme, admini mund të fshijë një kërkesë. Përveç kësaj, admini mund të krijojë manualisht një kërkesë për pushim për ndonjë punonjës të caktuar. Për menaxhim më të lehtë, ekziston një filtër që i mundëson adminit të shfaqë kërkesat sipas statusit të tyre, duke ndihmuar në identifikimin e shpejtë të atyre që janë në pritje, të aprovuara ose të refuzuara. Pas marrjes së vendimit, punonjësi do të marrë një njoftim me email, duke e informuar nëse kërkesa e tij është miratuar apo refuzuar. Ky sistem siguron një proces të qartë dhe të strukturuar për menaxhimin e pushimeve, duke e bërë administrimin e tyre më të lehtë dhe më efikas.

Employee	Leave Type	Start Date	End Date	Half Day?	Half-Day Type	Reason	Duration (Days)	Status	Rejected Reason	Approved/Rejected By	Actions
user	Vacation	2025-Mar-17	2025-Mar-19	X		Just feel like I...	3	Rejected	We dont feel ...	admin	Delete
user	Sick Leave	2025-Apr-05	2025-Apr-10	X		Not feeling w...	6	Approved		admin	Delete
user	Personal Leave	2025-Mar-16	2025-Mar-16	✓	Morning	Fix my car	0.5	Pending			✓ Approve ✗ Reject ...
admin	Personal Leave	2025-Mar-16	2025-Mar-16	✓	Morning	None	0.5	Pending			✓ Approve ✗ Reject ...
admin	Vacation	2025-Apr-01	2025-Apr-05	X		Family trip	5	Rejected	Insufficient le...	admin	Delete
user	Vacation	2025-Apr-01	2025-Apr-05	X		Family trip	5	Approved		admin	Delete

Figura 23. Leave Requests në Modulin Admin

Në figurën më poshtë është e hapur dritarja e cila mundëson paraqitjen e kërkesave nga Admini. Në këtë formë shënohet data e fillimit dhe mbarimit të pushimit, zgjedhet lloji i pushimit dhe caktohet arsyeja.

Request Leave

Start Date

End Date

Select Leave Type

☐ Half Day

Reason

Cancel

Submit

Figura 24. Paraqitja e kërkesave nga Admini

4.2.7 Daily Reports – Raportet Ditore

Daily Reports apo Raportet Ditore në modulin Admin ofron një hapësirë të dedikuar për menaxhimin dhe krijimin e raporteve ditore. Ky seksion përmban një formë ku admini mund të krijojë raporte mbi aktivitetet dhe performancën e punonjësve gjatë ditës. Përveç krijimit të

raporteve, aty shfaqet edhe një listë e të gjitha raporteve të krijuara më parë, duke i mundësuar administratorit të ketë një pasqyrë të qartë mbi historikun e dokumentuar. Për lehtësimin e kërkimit, është i disponueshëm edhe një filtër, i cili ndihmon në gjetjen më të shpejtë të raporteve specifike sipas datës ose kriterëve të tjera të përcaktuara. Ky funksionalitet ndihmon administratorin në monitorimin e përditshëm të punës dhe në marrjen e vendimeve të bazuara në të dhëna të sakta.




Figura 25. Daily Reports tek Moduli Admin

4.2.8 Profile – Profili

Profile apo Profili në modulën Admin shfaq informacionin e profilit të administratorit të kompanisë, duke ofruar një hapësirë të dedikuar për menaxhimin e llogarisë personale. Në këtë seksion, admini ka mundësinë të ndryshojë vetëm fjalëkalimin e tij për siguri më të lartë. Procesi i ndryshimit të fjalëkalimit kryhet përmes një forme të thjeshtë dhe të sigurt, ku kërkohet fjalëkalimi aktual dhe ai i ri. Ky seksion siguron një mënyrë të lehtë dhe efikase për mbrojtjen e llogarisë së administratorit dhe garanton një akses të sigurt në sistem.




Figura 26. Profili në Modulin Admin

4.3 Moduli Employee

Moduli Employee është një nga tre modulet kryesore të platformës UpTime dhe është i dedikuar për punonjësit e kompanive. Ky modul u mundëson punonjësve të ndjekin orarin e punës, të përmbushin detyrat e caktuara dhe të bëjnë kërkesa për pushim. Ndryshe nga Super-Admin dhe Admin, punonjësit kanë një nivel më të kufizuar të aksesit në sistem, pasi ata mund të përdorin vetëm funksionet që lidhen drejtpërdrejt me detyrat dhe aktivitetet e tyre të punës.

Funksionalitetet kryesore të Modulit Employee janë:

1. Regjistrimi i Orarit të Punës (Clock-In & Clock-Out)

Punonjësit kanë mundësinë të regjistrojnë orarin e punës në mënyrë të automatizuar përmes platformës. Ata mund të:

- Klikojnë Clock-In kur fillojnë punën.
- Klikojnë Clock-Out kur përfundojnë punën.
- Shikojnë historikun e orëve të punës për periudha të ndryshme kohore.
- Raportojnë ndonjë problem me regjistrimin e orarit, në rast të ndonjë gabimi teknik.

2. Shikimi dhe Përmbushja e Detyrave

Punonjësit mund të:

- Shikojnë listën e detyrave të caktuara nga Admin.
- Ndjekin statusin e detyrave (Në proces, Përfunduar, Vonuar).
- Komunikojnë me administratorin për ndonjë paqartësi ose vonesë në përfundimin e një detyre.

3. Shikimi i Orarit të Punës dhe Raporteve

Punonjësit mund të kenë akses në:

- Historikun e orëve të punës për periudha të ndryshme (ditore, javore, mujore).

4. Kërkesat për Pushim

Punonjësit kanë mundësinë të:

- Bëjnë kërkesa për pushim (pushim vjetor, leje shëndetësore, leje personale).
- Shikojnë statusin e kërkesës (Në pritje, Miratuar, Refuzuar).

5. Komunikimi me Administratën

Punonjësit mund të kenë nevojë të komunikojnë me administratorët për çështje të ndryshme. Platforma mund të ofrojë:

- Një hapësirë për komentime ose diskutime mbi detyrat.

4.3.1 Forma për kyçje në Modulin Employee

Në modulin Employee, punonjësit mund të kyçen në platformë për të regjistruar orarin e punës, për të ndjekur detyrat dhe për të paraqitur kërkesa për pushim. Menyja e kyçjes në këtë modul përmban hapësira për të shkruar emailin dhe fjalëkalimin, duke mundësuar identifikimin e përdoruesve sipas rolit të tyre. Në rast se një nga këto të dhëna shënohet gabim, shfaqet një mesazh që informon përdoruesin se kredencialet nuk janë të sakta dhe se nuk mund të kyçet. Gjithashtu, forma përmban validimin e të dhënave për të siguruar që fusha e emailit dhe fjalëkalimit të jenë të plotësuar siç duhet. Kyçja e mbrojtur siguron që çdo punonjës të ketë akses vetëm në të dhënat e tij personale dhe detyrat që i janë caktuar.


The image shows a login form for 'uptime' with the tagline 'time matters'. The form is titled 'Sign In' and includes fields for 'Email' (containing 'user@user.com') and 'Password' (masked with dots). There is a 'Forgot Password?' link and a 'Sign In' button. At the bottom, it says 'Dont have an account? Resgister your company [here.](#)'.

Figura 27. Forma për kyçje në Modulin Employee

4.3.2 Dashboard – Ballina

Ballina e modulit Employee në platformën UpTime ofron mundësinë për punonjës të regjistrojnë orarin e tyre të punës përmes një monitoruesi të kohës së punës. Ky funksionalitet mundëson Clock-In në fillim të punës dhe Clock-Out në përfundim, duke regjistruar saktësisht orët e punës. Sistemi ruan automatikisht të dhënat e regjistruara, duke krijuar një historik të kohës së punës për secilin punonjës. Kjo veçori ndihmon në monitorimin e orëve të punës, lehtëson raportimin për administratorin dhe siguron një pasqyrë të qartë mbi angazhimin e punonjësit në detyrat e tij ditore.




Figura 28. Ballina në Modulin Employee

4.3.3 Tasks – Detyrat

Tasks ose Detyrat në modulin Employee përmban seksionin e Listës së Detyrave, ku shfaqen të gjitha detyrat që punonjësi duhet të përmbushë. Detyrat janë të organizuara sipas statusit të tyre në detyrat në pritje (pending tasks), detyrat në proces (in progress tasks) dhe detyrat e përfunduara (done tasks). Punonjësi ka mundësinë të menaxhojë statusin e detyrave, duke i kaluar nga një status në tjetrin në varësi të progresit të punës së tij. Gjithashtu, ai mund të lërë komente për secilën detyrë, duke komunikuar me administratorin për çdo paqartësi apo përditësim. Ky seksion ndihmon në organizimin dhe ndjekjen efektive të punës, duke i mundësuar punonjësit të menaxhojë më mirë angazhimet e tij.




Figura 29. Tasks në Modulin Employee

Ne këtë figurë është paraqitur dritarja e cila hapet pasi te klikojmë në modifikimin e detyrës së caktuar. Këtu mund të menaxhohet statusi i detyrave, duke ndryshuar statusin dhe mund të bëhen komente rreth detyrës për të komunikuar me administratorin.





Figura 30. Modifikimi i Detyrës në Modulin Employee

4.3.4 Work History – Historia e Punës

Work History apo Historia e Punës në modulën Employee shfaq historikun e punës së punonjësit që është i kyçur në sistem. Në këtë seksion paraqitet një formë e detajuar ku shfaqen data e regjistrimit, koha e fillimit të punës (Clock-In), koha e përfundimit të punës (Clock-Out) dhe koha totale e punës për secilën ditë. Gjithashtu, për lehtësimin e kërkimit, platforma ofron një filtër, i cili i mundëson punonjësit të gjejë më shpejt historikun e punës për një datë të caktuar. Ky funksionalitet ndihmon në ndjekjen dhe analizimin e angazhimit të punonjësit, duke ofruar transparencë mbi orët e punës së regjistruara.



The screenshot displays the 'My Attendance History' section of the Uptime application. It features a sidebar with navigation links: Dashboard, Tasks, Work History (selected), Company, Leave Requests, Daily Reports, and Profile. The main content area shows a table of attendance records with columns for Date, Clock In, Clock Out, Status, and Total Time. The table contains six rows of data, all with a status of 'clocked-out'. A filter by date is available above the table. The footer of the page includes 'About', 'Feedback', and user information for 'USER'.

Date	Clock In	Clock Out	Status	Total Time
2025-Mar-16 17:00:50	2025-Mar-16 17:00:50	2025-Mar-16 17:01:07	clocked-out	16s
2025-Mar-16 15:20:03	2025-Mar-16 15:20:03	2025-Mar-16 15:21:21	clocked-out	1m 18s
2025-Mar-16 15:06:11	2025-Mar-16 15:06:11	2025-Mar-16 15:06:24	clocked-out	12s
2025-Mar-16 15:05:33	2025-Mar-16 15:05:33	2025-Mar-16 15:06:07	clocked-out	34s
2025-Mar-15 15:01:40	2025-Mar-15 15:01:40	2025-Mar-15 15:01:42	clocked-out	1s

Figura 31. Work History në Modulën Employee

4.3.5 Company – Kompania

Company apo Kompania në modulën Employee është e ngjashme me atë në modulën Admin, por me disa të dhëna më të kufizuara. Punonjësi mund të shohë informacionet bazë të kompanisë si emrin, llojin, adresën, faqen e internetit, kontaktin, rregullat e kompanisë, ditët dhe oraret e punës. Megjithatë, ndryshe nga Admin, punonjësi nuk ka akses për të parë statusin e kompanisë dhe numrin e punonjësve. Ky seksion i ofron punonjësit një pasqyrë të përgjithshme mbi rregullat dhe organizimin e punës në kompani, duke e ndihmuar të përshtatet me strukturën dhe oraret e saj.




Figura 32. Company në Modulin Employee

4.3.6 Daily Reports – Raportet Ditore

Daily Reports apo Raportet Ditore në modulin Employee i mundëson punonjësit të krijojë dhe të regjistrojë raporte ditore mbi punën e kryer. Punonjësi mund të shkruajë një raport duke përcaktuar titullin dhe një përshkrim të detajuar të aktiviteteve të tij gjatë ditës. Përveç krijimit të raporteve të reja, në këtë seksion punonjësi ka mundësinë të shohë të gjitha raportet e mëparshme që ka shkruar, duke pasur një pasqyrë të qartë mbi dokumentimin e progresit të tij në punë. Ky funksionalitet ndihmon në mbajtjen e një regjistri të saktë të aktiviteteve ditore dhe përmirëson komunikimin e punonjësit me administratorët mbi detyrat dhe përformancën e tij.




Figura 33. Daily Reports në Modulin Employee

4.3.7 Leave Requests – Kërkesat për Pushime

Leave Requests apo Kërkesat për Pushime në modulën Employee i mundëson punonjësit të bëjë kërkesa për pushim duke plotësuar të dhënat e nevojshme, si data e fillimit dhe përfundimit të pushimit, lloji i pushimit, kohëzgjatja dhe arsyeja e kërkesës. Përveç dorëzimit të kërkesave, punonjësi ka mundësinë të shohë të gjitha kërkesat e tij të mëparshme dhe të kontrollojë statusin e tyre, duke parë nëse janë pranuar apo refuzuar nga admini. Ky funksionalitet ndihmon punonjës të menaxhojë më mirë ditët e pushimit dhe të ketë një pasqyrë të qartë mbi kërkesat e tij.

Employee	Leave Type	Start Date	End Date	Half Day?	Half Day Type	Reason	Duration (Days)	Status	Rejected Reason
user	Vacation	2025-Mar-17	2025-Mar-19	✗		Just feel like it...	3	Rejected	We dont feel like it...
user	Sick Leave	2025-Apr-05	2025-Apr-10	✗		Not feeling well...	6	Approved	
user	Personal Leave	2025-Mar-16	2025-Mar-16	✓	Morning	Fix my car	0.5	Pending	
user	Vacation	2025-Apr-01	2025-Apr-05	✗		Family trip	5	Approved	

Figura 34. Leave Requests në Modulën Employee

Në këtë figurë është paraqitur dritarja e cila hapet kur klikohet në butonin Request Leave. Në këtë pjesë bëhet kërkesa për pushim, shënohet data e fillimit dhe përfundimit të pushimit, lloji i pushimit, kohëzgjatja dhe arsyeja e kërkesës. Me klikimin e butonit Submit dërgohet kërkesat tek administartori.




Figura 35. Kërkesat për pushim në Modulin Employee

4.3.8 Profile – Profili

Profile apo Profili në modulën Employee është e ngjashme me atë në modulet tjera dhe shërben për menaxhimin e llogarisë personale të punonjësit. Në këtë seksion, punonjësi ka mundësinë të ndryshojë vetëm fjalëkalimin e tij për siguri më të lartë. Ndryshimi i fjalëkalimit kryhet përmes një forme të thjeshtë dhe të sigurt, duke kërkuar fjalëkalimin aktual dhe atë të ri. Ky seksion siguron një mënyrë të lehtë dhe efikase për mbrojtjen e llogarisë dhe garanton një akses të sigurt në sistem.




Figura 36. Profili në Modulin Employee

5 Përfundimi

Platforma "UpTime" përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt digjitalizimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, duke ofruar një sistem të plotë për ndjekjen e kohës së punës, administrimin e detyrave dhe organizimin e pushimeve të punonjësve. Duke përdorur teknologjinë MERN Stack dhe sistemin RBAC, platforma siguron një qasje moderne dhe të personalizueshme për bizneset që kërkojnë të optimizojnë proceset e tyre të punës.

Një nga avantazhet kryesore të "UpTime" është fleksibiliteti dhe mundësia e adaptimit sipas nevojave të ndryshme të kompanive. Automatizimi i proceseve të menaxhimit të stafit redukton gabimet njerëzore, përmirëson saktësinë e regjistrimeve dhe rrit efikasitetin e përgjithshëm të organizatës. Përveç kësaj, raportimi i detajuar i orëve të punës dhe aktivitetit të punonjësve ndihmon administratorët dhe menaxherët të marrin vendime më të informuara.

Gjatë zhvillimit të platformës, u adresuan sfida të ndryshme, përfshirë sigurimin e një ndërfaqeje të lehtë për përdorim, optimizimin e performancës së sistemit dhe implementimin e një mekanizmi të sigurt për menaxhimin e të dhënave. Zgjidhjet teknike të zbatuara sigurojnë që "UpTime" të jetë një platformë e besueshme, e shkallëzueshme dhe e përshtatshme për përdorim në kompani të çdo madhësie. Në të ardhmen, "UpTime" mund të zgjerohet me funksionalitete të reja, si integrimi me sisteme të tjera të menaxhimit të burimeve njerëzore, përdorimi i analitikës së të dhënave për monitorimin e performancës së punonjësve dhe aplikimi i inteligjencës artificiale për parashikimin e nevojave të stafit. Kjo platformë jo vetëm që modernizon menaxhimin e burimeve njerëzore, por gjithashtu shërben si një model për zhvillimin e mëtejshëm të teknologjive të automatizuara në këtë fushë.

6 Referencat

- 1 Design, A. (n.d). *Ant Design - The world's second most popular React UI framework*. Gjetur në Ant Design - The world's second most popular React UI framework.
- 2 Express.js. (n.d). *Express-Node.js web apllication framework*. Gjetur në <https://expressjs.com/>
- 3 MaterialUI. (2025). *Material UI Templates*. Gjetur në MUI: <https://mui.com/material-ui/getting-started/templates/?srsId=AfmBOoo19GsGxawNnb6Z64km1SAaRONGNsxRqLNpOvhcLgOl6y8d8KOc>
- 4 Mongo.db. (n.d). *MongoDB - The developer data platform*. Gjetur në <https://www.mongodb.com/>
- 5 MUI. (n.d). *MUI: The React component library you always wanted*. Gjetur në <https://mui.com/>
- 6 Node.js. ((n.d)). *Node.js*. Gjetur në <https://nodejs.org/en>
- 7 React. (n.d). *React – A JavaScript library for building user interfaces*. Gjetur në <https://react.dev/>
- 8 Redux. (a.d.). *A predictable state container for JavaScript apps*. Gjetur në A predictable state container for JavaScript apps.
- 9 *Rregullorja për projekte*. (2017, 11). Retrieved 2025, from Univerziteti Kadri Zeka: <https://www.uni-gjilan.net/fakultete/rregullorja-per-projektet/>
- 10 Tailwind. (n.d). *Tailwind CSS - Rapidly build modern websites without ever leaving your HTML*. Gjetur në <https://tailwindcss.com/>
- 11 TypeScript. (n.d). *TypeScript: JavaScript with syntax for types*. Gjetur në <https://www.typescriptlang.org/>
- 12 UI, M. (2025). *Materia UI Templates*. Gjetur në MUI: <https://mui.com/material-ui/gettingstarted/templates/?srsId=AfmBOoo19GsGxawNnb6Z64km1SAaRONGNsxRqLNpOvhcLgOl6y8d8KOc>
- 13 Vite. (n.d). *Vite: Next Generation Frontend Tooling*. Gjetur në <https://vite.dev/>

